

# TË DREJTAT E NJERIUT

Të Drejtat  
e Njeriut



# MBROHEN NË DEMOKRACI

## E ARDHMJA ËSHTË NË DUART TONA

ADEA (10), ARGITA (10), ALBIONA (10), ETNIKA (10), LEON (11), ENDI (11), LEONITA (11)



### Në demokraci, ne vendosim se kush do të jetë zëri ynë në institucionet më të larta të shtetit


Demokracia është mënyrë e udhëheqjes së shtetit, ku qytetarët janë ata të cilët vendosin për të ardhmen e shtetit të tyre. Demokracia është sistem i qeverisjes, i cili njihet nga e gjithë bota, sepse ka lindur shumë vjet më parë. Më saktësisht, ajo është shfaqur në vitin 507 para erës së re, në kryeqytetin e Greqisë, në Athinë. Fjala demokraci rrjedh nga fjalët greke “demos” që do të thotë popull dhe “kratos” që do të thotë udhëheqje. Të mirat e demokracisë janë të shumta, p.sh. në demokraci të gjithë qytetarët janë të barabartë pa dallim moshe, feje, gjinie, etnie, etj. Mandej, shtetet demokratike janë shtete paqësore, sepse demokracia e kundërshton plotësisht luftën. Gjithashtu, të gjithë qytetarët e respektojnë dhe e ndihmojnë njëri-tjetrin, sepse në këtë mënyrë lehtësohet jeta e secilit qytetar.

Dy format më të njohura të demokracisë janë: demokracia e drejtpërdrejtë dhe demokracia përfaqësuese. Në Kosovë kemi demokraci përfaqësuese me sistem parlamentar, që do të thotë se qytetarët e Kosovës i zgjedhin përfaqësuesit që të flasin në emrin e tyre. Kështu që këta përfaqësues janë të obliguar t'i mbrojnë interesat e qytetarëve. Mënyra se si zgjedhen përfaqësuesit tanë, është e ngjashme me atë se si ne e zgjedhim kryesinë e klasës në shkollë, pra me anë të votave.

Meqënëse në demokraci shprehemi lirshëm, kemi të drejta të shumta dhe nuk ka luftë, a nuk do të ishte më mirë që çdo shtet i botës të ishte shtet demokratik? Ne jemi të gëzuar që kemi një mënyrë të tillë të qeverisjes dhe një gëzim të tillë ua urojmë të gjitha shteteve anë e mbanë botës.




Gazetarët e Kuvendit të Kosovës




Çdo kush ka të drejtë të zgjedhë profesionin që dëshiron



Para ligjit të gjithë jemi të barabartë



Shkollimi është i domosdoshëm për një të ardhme të ndritur



Barazia, element kyç i demokracisë



Gazetarja duke vizatuar



Të drejtat e njeriut në demokraci



Përgjegjësitë e qytetarëve

# LIGJET GARANTOJNË TË DREJTAT TONA

FLORI (10), POEMA (10), VESA (11), ANDA (11), ARBANA (9), GANI (11), SERJA (11)

## Jemi të lumtur që jetojmë në një vend, ku ne mund të shprehim mendimet tona

Në shtetin ku jetojmë kemi shumë të drejta dhe liri. Edhe ne si fëmijë kemi të drejtën e emrit dhe të familjes, të drejtën e mësimit, të drejtën e lojës, të komunikimit, të strehimit, të shkollimit, etj. Përveç këtyre kemi edhe ligje, të cilat ne duhet t'i zbatojmë si qytetarë të popullit. Ligjet janë ato rregulla, të cilat na e bëjnë jetën më të mirë. Të gjitha ligjet e propozuara duhet të bazohen në Kushtetutën e Kosovës.

Këto ligje i miraton Kuvendi, i cili është një institucion shumë i rëndësishëm në shtetin tonë demokratik. Në Kuvend i shqyrtojnë dhe i votojnë ligjet përfaqësuesit e popullit, që ndryshe njihen si deputetë. Përveç këtij funksioni, funksionit legjislativ, Kuvendi ka edhe dy funksione të tjera, të cilat janë: funksioni kontrollues (mbikëqyr Qeverinë) dhe funksioni përfaqësues.

Pra, ne si qytetarë duhet t'i respektojmë ligjet e shtetit tonë Kosovës, sepse ato na rregullojnë jetën.




Grupi „Gazetarët e famshëm“



Deputetët, përfaqësuesit e popullit



Kushtetuta, ligj mbi ligjet



Të drejtat e barabarta



Secili gëzon të drejtën e votës

# GAZETARËT AKTIV

GERSA (10), RILIND (11), DIAR (11), ENISA (11), RRONA (11), EDENJA (11)



## Ne jemi gazetarë aktiv, por jemi edhe qytetarë aktiv. Bëhuni edhe ju si ne

Ne jemi njerëz të ndryshëm. Megjithatë, edhe pse jemi të ndryshëm, ka diçka që na bashkon. E kjo është barazia. Kjo nënkupton se të gjithë ne jemi të barabartë para ligjit si dhe kemi të drejta të barabarta.

Të drejtat tona si qytetarë janë: të shkollohemi, të shprehemi lirshëm, të votojmë, të argëtohemi, etj. Këto të drejta i gëzojmë të gjithë njëjtë, pavarësisht gjinisë racës, fesë, apo gjendjes ekonomike.

Të jesh qytetar nënkupton të jetosh brenda një shteti të caktuar. Gjithashtu, duhet të kesh leje qëndrimi në atë vend. Të jesh qytetar, po ashtu nënkupton të jesh pjesë e vendimmarrjes. Vendimet mund t'i marrim duke marrë pjesë në procesin zgjedhor. Ky proces është jashtëzakonisht i rëndësishëm për vendet demokratike.

Ne jemi fëmijë të moshës 10-11 vjeçare. Megjithatë, edhe ne kemi votuar. Për shembull, ne kemi votuar për Ditën e Shkollës sonë, se kush nga ne do të recitonte, kush do të vallëzonte, e kush do të këndonte. Ne po ashtu, votuam për përfaqësuesit e grupit tonë shoqëror, që e krijuam për të mësuar më shumë rreth natyrës. Mirëpo, pasi të arrijmë moshën 18 vjeçare, ne do të kemi të drejtë të marrim pjesë në procesin zgjedhor. Për këtë fakt jemi shumë të entuziasmuar. Ne sot kuptuam se vota jonë është vula e së ardhmes. Pjesëmarrja jonë në zgjedhje nënkupton se ne jemi qytetarë

aktiv. Përpos pjesëmarrjes në zgjedhje, aktiv mund të jemi edhe duke marrë pjesë në tubime publike, duke nënshkruar peticione të ndryshme, duke votuar në referendume të caktuara, duke e mbrojtur ambientin, etj. Demokracia na mundëson të kemi shumë të drejta, ky është një fakt i pamohueshëm. Por, patjetër se me të drejtat vijnë edhe përgjegjësitë. Që do të thotë se, ne qytetarët e shteteve demokratike kemi edhe përgjegjësi ndaj shtetit tonë. Respektimi i ligjit, ruajtja e objekteve apo pronave publike, pagimi i taksave dhe mbrojtja e ambientit janë vetëm disa nga përgjegjësitë tona. Prandaj, duhet të jemi të përgjegjshëm dhe ta ruajmë e ta duam vendin tonë. Dashuria tregohet me kujdes, andaj le të kujdesemi që vendi ynë të jetë i bukur, i suksesshëm dhe një shtëpi e ngrohtë për të gjithë ne, qytetarët e vendit tonë. Gjithashtu, të mos harrojmë ta duam dhe ta respektojmë njëri-tjetrin, në mënyrë që të kemi një demokraci sa më të mirë.



Gazetarët punëtorë të këtij artikulli



## IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI  
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA  
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



**ERSTE Stiftung**

Redaktohet nga  
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit  
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga  
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë: Pjesëmarrësit:  
Tel: +381 38 704 560 SHFMU „Mustafa Bakija“  
E-mail: info@demos-ti.org Klasa: V-6  
Website: www.demos-ti.org Vendi: Gjakovë